



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government

Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo zdravstva - Ministry of Health
Divizioni i Prokurimit/Divizia Nabavke/Procurement Division

Prishtine datë, 13.01.2025

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Ministrisë së Shëndetësisë, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 të Rregullores për Prokurim Publik të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 03.01.2025, të parashtruar nga Grupi i OE: PACS and Workflow System (NOVUS), lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Furnizimi, implementimi dhe mirëmbajtja e sistemit Packs dhe RIS të SISH"** me nr. prokurimi 206-23-13309-1-1-1, nxjerr:

V E N D I M

1. **Refuzohet**, si e pa bazuar kërkesa për ri-shqyrtim e Grupi i OE: PACS and Workflow System (NOVUS), e dt. 03.01.2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit **"Furnizimi, implementimi dhe mirëmbajtja e sistemit Packs dhe RIS të SISH"** me nr. prokurimi 206-23-13309-1-1-1, kundër Njoftimit mbi vendimin e AK, të datës 30.12.2024;
2. Mbetet në fuqi, Njoftimi mbi vendimin e AK i datës 30.12.2024;
3. Autoriteti Kontraktues, e konsideron të mbyllur aktivitetin e prokurimit;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Grupi i OE: PACS and Workflow System (NOVUS), me datën 03.01.2025, ka parashtruar kërkesë për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Furnizimi, implementimi dhe mirëmbajtja e sistemit Packs dhe RIS të SISH"** me nr. prokurimi 206-23-13309-1-1-1. Autoriteti Kontraktues, me datë 13.01.2025, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga AK sipas OE ankues:

Neni 6 - Ekonomiciteti dhe Efikasiteti - përcakton obligimin e AK që të sigurojë që fondet të përdoren në mënyrën më ekonomike, duke marrë parasysh qëllimin dhe lëndën e prokurimit, kjo duke qenë se fondet sigurohen nga burimet publike.

Neni 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve - AK nuk vlerëson ofertën e OE PACS and Workflow System në mënyrë të drejtë dhe në përputhje me Dosjen e Tenderit, kjo pasi që OE në fjalë ka plotësuar të gjitha kërkesat dhe kriteret e përcaktuara nga AK, për çka oferta e të njëjtit duhet të konsiderohet si e përgjegjshme dhe ti jepet kontrata për aktivitetin e prokurimit në fjalë.

Pretendimet ankimore te OE ankues:

OE PACS and Workflow System paraqet këtë Kërkesë për Rishqyrtim kundër Njoftimit mbi Vendimin e Autoritet Kontraktues të datës 30 Dhjetor 2024 për aktivitetin e prokurimit me nr. 206-23-13309-1-1-1, me të cilin AK e anulon aktivitetin e prokurimit duke e vlerësuar ofertën e OE PACS and Workflow System si të papërgjegjshme.

AK ka vlerësuar se OE PACS and Workflow System nuk ka dorëzuar një ofertë të papërgjegjshme për shkak se:

- (1) OE PACS and Workflow System nuk ka zhvilluar produkt në disa arkitektura në shumë faqe
- (2) OE nuk ka zbatuar një projekt në një shtet të BE-së
- (3) Nuk ka treguar se sistemi i zhvilluar do të bëj integrimin me paisjet me MRI dhe CT
- (4) Nuk ka ofruar arkitekturë modulare fleksibile të zgjerimit në të ardhmen;
- (5) Sigurimi i mekanizmave të sigurtë të autentifikimit;
- (6) Does not have an option for lockable front panel;
- (7) Does not have a sensor to open the housing;
- (8) Does not have an option for server housing
- (9) Does not have possibility for alarm
- (10) Does not have a processor minimum 24 cores

Në kundërshtim të kësaj, OE PACS and Workflow System paraqet pretendimet si në vijim bazuar në pikat e lartcekura

(1) Pretendimi se OE PACS and Workflow System nuk ka zhvilluar produkt në disa arkitektura në shumë faqe

Ky pretendim i AK nuk qendron dhe nuk është i bazuar, pasi nuk jep ndonjë arsytim të qartë apo konkret për mënyrën se si propozohet se produkti i ofertuar nuk është i ndërtuar në shumë faqe. Për më tepër, Propozimi Teknik i dorëzuar nga OE PACS dhe Workflow System përfaqëson një strukturë të shume mirë të organizuar dhe gjithëpërfshirëse, duke përfshirë arkitekturat në shume faqe në pika të ndryshme të dokumentit, të cilat ndërlidhen nga të gjitha pjesët për të siguruar një qasje të harmonizuar dhe koherente. Çdo element i produktit të ofertuar është zhvilluar në përputhje me kërkesat dhe qëllimet specifike të projektit, duke reflektuar një analizë dhe planifikim të detajuar.

Nëse analizohet mire dokumenti i Propozimi Teknik të dorëzuar nga OE PACS dhe Workflow System qysh nga pika 2.6.1 deri me 2.6.19 përfshin të gjitha ndërlidhjet mes faqeve dhe ka një arkitekturë të avancuar lidhur me shume faqe dhe disa ndërlidhje të caktuara. Në të njëjtën kohë në ndërlidhje me pretendimin (2) është theksuar se ky sistem do të ketë ngjashmëri me atë të BE-së ku vërehet qartë multi-site system.

(2) Pretendimi se OE PACS and Workflow System nuk ka zbatuar një projekt në një shtet të BE-së

Ky pretendim i AK-se nuk qendron dhe nuk është i bazuar pasi që për këtë kërkesë OE PACS and Workflow System ka paraqitur 2 referenca/projekte të implementuara. Njëra për zgjidhjen Pinga produktin/RIS, si dhe tjetra për zgjidhjen MedDream PACS. Për të dy projektet multi-site (me shume faqe) të implementuara janë dhënë referencat e kontaktit për tu kontaktuar dhe verifikuar projektet e implementuara. Zgjidhja teknike e ofruar tregon se si zgjidhja e OE PACS and Workflow System janë implementuar me sukses në disa arkitektura multi-site. Për shembullin e RIS, në zgjidhjen e ofruar nga OE PACS and Workflow System, me saktësisht në seksionet 2.8.1 – 2.8.9, tregohet arkitektura për një implementim workflow multi-site, së bashku me një kontakt që mund të ofrojë informacion shtesë. Për shembullin e PACS, në zgjidhjen e ofruar nga OE PACS and Workflow System, me saktësisht në seksionin 2.8.10, tregohet arkitektura për një implementim multi-site të PACS, së bashku me një kontakt që mund të ofrojë informacion shtesë. Ashtu siq është edhe kërkesë

e dosjes se tenderit AK mund ti kontaktoj personat përgjegjës për te vertetuar që këto referenca/projekte janë të implementuara totalisht dhe janë shumë funksionale.

Pra, ky pretendim i AK nuk qëndron pasi në faqe 56 të Propozimit teknik apo pika 2.8.9 theksohet se është zhvilluar një projekt i ngjashëm dhe poashtu pika 2.8.10. Përckaton një arkitekturë në disa faqe (multi-site architecture) për Meddream PACS në Lituani.

Duke qenë se Lituania është një shtet në BE përmbushet kjo kërkesë specifike e AK kontraktues. Poashtu OE ka dhënë edhe detaje lidhur me strukturën e arkitekturës së projektit të zhvilluar dhe të njëjtën kohë e ka dhënë edhe kontaktin e referencës lidhur me produktin e zhvilluar të ngjashëm në projektin e BE-së.

(3) Pretendimi se Sistemi i zhvilluar nuk do të bëjë integrimin me pajisjet me MRI dhe CT

Pretendimi që sistemi i propozuar nga OE PACS dhe Workflow System nuk do të bëjë ndërlidhjet me pajisjet MRI dhe CT poashtu nuk qëndron, pasi që në faqe 20 e tutje përkatësisht pika 2.6.11, parashikon të gjithë sistemin e pjesës së radiologjisë ku përfshihet MRI dhe CT. Ku fillimisht,

bëhet edhe organizimi i punës, shikimi i të gjithë historisë dhe fotografimeve të kaluara, edhe poashtu shikimi i raportit sinoptic. Poashtu kjo çështje është sqaruar te pjesa e kërkesës për sqarime shtese nga përgjigjja e dorëzuar nga ana OE PACS and Workflow System që ka theksuar si më poshtë:

Kërkesa në dosje	Zgjidhja e ofruar nga OE 'PACS and workflow System
3.4. Integrimi i Modaliteteve 3.4.1. Modalitetet e skanerëve CT, MRI, Sistemet CR, Sistemet DR, Sistemet e Mamografi, C-Arm, Fluoroskopi, Angiografia, Cath Lab, ECG, EEG, Ultrasound / Doppler ngjyre, Endoskopi, Densitometria e kockave, Kamera bërthamore, Radioterapia, Skaneri XRay dhe Kamera me lazer duhet të jenë të lidhura.	Për Integrimin e Modaliteteve, OE ka konfirmuar se zgjidhja e propozuar plotëson këtë kërkesë dhe të gjitha modalitetet e renditura mbështeten nga zgjidhja e propozuar
3.4.2. Duhet të ketë integrim DICOM, përderisa modaliteti është i pajisur me licencat përkatëse. Oferuesit duhet të sigurojnë licenca DICOM të pakufizuara (Store, Send, Modality eorklist, Query / Retrieve, etj.) për të integruar modalitetet DICOM. Licencat e munguar DICOM në modalitetet do të sigurohen nga spitali.	Zgjidhja jonë e propozuar nga OE plotëson këtë kërkesë dhe nuk ka kufizime licencash për zgjidhjen e propozuar.

Sqarim shtesë: Për secilën kërkesë nga dosja e tenderit OE PACS and Workflow System është përgjigj dhe ka konfirmuar se zgjidhja e ofruar plotëson kërkesat. Kjo është dhe e demonstruar gjithashtu. Certifikatat e përputhshmërisë janë ofruar si pjesë e përgjigjes dhe tregojnë

përputhshmërinë me të gjitha standardet përkatëse (DICOM, HL7) dhe një numër të madh pajisjesh.

Këto informacione janë në dispozicion dhe publikisht dhe shume lehte te vertetueshme:

<https://meddream.com/products/meddream-pacs-serve/>

<https://meddream.com/company/#certifications>

Prandaj ky pretendim i AK që nuk do të bëhet integrimi me këto pajisje nuk qëndron dhe nuk është aspak i bazuar.

(4) Pretendimi se OE PACS and Workflow System nuk ka ofruar arkitekturë modulare fleksibile të zgjerimit në të ardhmen;

Ky pretendim i AK nuk qëndron, pasi që OE PACS and Workflow System ka përmbushur këtë kriter duke ofruar zgjidhjen për Platformën Pinga e cila është zgjidhja e integruar softuerike modulare duke përmbushur të gjitha kërkesat në dosjen e tenderit. Kjo është demonstruar qartë përgjatë gjithë propozimit teknik, si dhe veçanërisht në seksionet 2.6.1, 2.6.2 dhe 2.6.19; si dhe nëpërmjet tabelës së përgjigjeve teknike të detajuara (tek seksioni 3) dhe gjithashtu gjatë gjithë propozimit teknik. OE PACS and Workflow System ka implementime aktive ndërkombëtare që

e demonstrojnë këtë dhe janë të cituara në listen e kontratatave dhe referencave të paraqitura në ofertën tonë. Edhe pse në dosjen e tenderit nuk ka kërkesë specifike që Arkitektura duhet të jetë modulare dhe fleksibël për të mundësuar zgjerime të lehta në të ardhmen pa ndryshime teknologjike të mëdha, mirëpo zgjidhja teknike e paraqitur nga OE PACS and Workflow System e ofron këtë. Gjithashtu edhe përgjatë sqarimeve nuk ka pasur kërkesë të tillë nga AK.

Prandaj pretendimi i AK që OE PACS and Workflow System nuk ka dorëzuar këtë pjesë nuk qëndron dhe nuk është aspak e bazuar pasi që edhe tek kërkesa për sqarime shtese OE PACS and Workflow System ka dorëzuar informata mbi çështjen në fjalë.

(5) Pretendimi se OE nuk ka ofruar mekanizma të sigurtë të autentifikimit;

Kërkesa në dosje :	Zgjidhja e ofruar nga OE 'PACS and workflow System'
(3.3.7.) Autentifikimi i sistemit operativ duhet të mundësojë trashëgiminë e tij, në mënyrë që të mos kërkohet një login i veçantë në softuerin e aplikacionit. (6.1.5.) Zgjidhja duhet të mbështesë mundësinë e dërgimit të imazheve për lexim	Pinga mund të lidhet me Microsoft AD dhe AAD, mbështet SSO dhe integrimin në nivel grupi. Zero-footprint vieëer është rruga e zgjedhur për të siguruar portabilitet dhe kompatibilitet maksimal. Përsa i përket autentifikimit 2FA, zgjidhja e propozuar

të dytë ose të tretë të klinikistët e jashtëm përmes një autentifikimi të sigurt me token, dhe qasja në imazhet e ofruara duhet të realizohet përmes një mekanizmi të tillë si DICOM TLS, dërgimi i imazheve, ose një shikues pa asnjë footprint.
(7.1.2.) Për të parë të dhënat e ndara, duhet të implementohet një autentifikim me dy faktorë.

plotëson këtë kërkesë dhe zero-footprint vieër HTML5 DICOM është rrua e zgjedhur, për të siguruar portabilitet dhe kompatibilitet maksimal. Funkcionaliteti i URL-së është integruar me autentifikimin e sistemit, dhe gjithashtu mbështet një zgjidhje të autentifikimit të validuar (duke përdorur 2FA dhe '3FA' (DOB + OTP) për pacientët dhe profesionistët që nuk janë përdorues të rregullt të sistemit).

Zgjidhja e propozuar nga OE PACS and Workflow System e plotëson këtë kërkesë. Siç përshtrohet në zgjidhjen teknike të paraqitur, Pinga mund të lidhet me Microsoft AD dhe AAD, mbështet SSO dhe integrimin në nivel grupi. Zero-footprint viewer është rrua e zgjedhur për të siguruar portabilitet dhe kompatibilitet maksimal. Përsa i përket autentifikimit 2FA, zgjidhja e propozuar plotëson këtë kërkesë dhe zero-footprint viewer HTML5 DICOM është rrua e zgjedhur, për të siguruar portabilitet dhe kompatibilitet maksimal. Funkcionaliteti i URL-së është integruar me autentifikimin e sistemit, dhe gjithashtu mbështet një zgjidhje të autentifikimit të validuar (duke përdorur 2FA dhe '3FA' (DOB + OTP) për pacientët dhe profesionistët që nuk janë përdorues të rregullt të sistemit). Kjo është demonstruar në tabelën e përgjigjeve teknike të detajuara (seksioni 3), veçanërisht në përgjigjet për 7.1.1, 7.1.2. MFA është një standard i ofruar si pjesë e zgjidhjes sonë të workflow.

Prandaj ky pretendim i AK-së lidhur se nuk ka ofruar sigurim të autentifikimit nuk qëndron pasi që OE PACS and Workflow System edhe gjatë kërkesës për sqarime ka dhënë informata të mjaftueshme lidhur me zgjidhjen softuerike.

Ndërsa lidhur me pikat nga 6 e tutje më poshtë gjeni detajet që vecse janë të paraqitur në Propozimin teknik të OE PACS and Workflow System, që paraqesin faktin që ato janë ofertuar.

- (6) Does not have an option for lockable front panel;
- (7) Does not have a sensor to open the housing;
- (8) Does not have an option for server housing
- (9) Does not have possibility for alarm
- (10) Does not have a processor minimum 24 cores

4. PROPOSED TECHNICAL SOLUTION FOR HARDWARE

	<p>Regional servers (x7) Proposed model: Dell PowerEdge T550 Server</p>
	<p>Option for lockable front panel of the server housing, restricts access to the the hard disk drives.</p> <p>Option for a sensor to open the housing with the possibility of remote alarm settings for this event.</p> <p>Each server must include at least one processor. The processor must have at least 8 cores, 16 threads, 12M cache, 2.8Ghz base frequency. Processor: Intel® Xeon® Silver 4309Y 2.8G, 8C/16T, 10.4GT/s, 12M Cache, Turbo, HT (105W) DDR4-2666</p> <p>The number of memory slots is at least 16, with support for total memory up to 1 TB</p> <p>The amount of RAM should be at least 64 GB DDR4, the frequency of not less than 3200 MHz Memory Capacity: (2) 32GB RDIMM, 3200MT/s, Dual Rank, 16Gb BASE x8 - 64GB in total</p> <p>Must have at least 1 module with at least 2 x 10GbE BASE-T, OCP 3.0 Network Adapters ; Intel X710-T2L Dual Port 10GbE BASE-T, OCP NIC 3.0</p> <p>Must have integrated 2 x 1Gb Base-T ports Motherboard: PowerEdge T550 Motherboard with Broadcom 5720 Dual Port 1Gb On-Board LOM, V4</p>

Technical Specifications

Included ports:
Front Ports: 1x micro-usb, 1x USB 2.0, 1x USB 3.0
Rear Ports: 1x USB 2.0, 1x USB 3.0, 1x VGA
Internal: 1x USB 3.0 (optional)
Has the ability to install at least 8 disk drives inside the server enclosure, supported types of SAS/SATA drives, NL-SAS, SSD. The servers will be offered with at least two (2) 8TB NL SAS drives.

	<p>Control server (x1) Proposed model: Dell PowerEdge R760XD2 Server</p>
	<p>Option for lockable front panel of the server housing, restricts access to the hard disk drives.</p> <p>Option for a sensor to open the housing with the possibility of remote alarm settings for this event.</p> <p>The server must include at least two the latest generation processors. Each processor must have at least 16 cores, 32 threads, 30M cocho, 2.0Ghz base frequency. Processor: 2 x Intel® Xeon® Silver 4514Y 2G, 16C/32T, 16GT/s, 30M Cocho, Turbo, HT (150W) DDR5-4400</p> <p>The number of memory slots is at least 16, support for total memory up to 1TB</p>
Technical specifications	

	Brand Name Workstations (x70) Pcs Proposed model: Dell Precision 3460 Small Form Factor PC Workstation
Model	Dell Precision 3460 Small Form Factor PC Workstation
Chassis	Small Format Factor
Processor	Minimum 24 cores (out of which 8 Performance-cores and 16 Efficient-cores) with total of 32 threads and 36MB intel smart cache. Frequency for the Performance-cores need to be in range of 2.0 GHz to 5.2 GHz and 1.5 GHz to 4.2 GHz on Efficient-cores Processor: A - Intel® Core™ i9-13900 (36MB Cache, 24 Core (8+16), 2.0GHz to 5.6GHz (65W)) TDP
Operating System	Microsoft Windows 11 Professional
Graphic card	Minimum video card with 12 GB GDDR6 with 4 mDP connections Graphics: NVIDIA® RTX™ A2000 12GB, 12 GB GDDR6, 4 mDP

Në këtë drejtim në raste të tilla, kur dorëzohet një ofertë e përgjegjshme dhe e cila i plotëson të dy kriteret vendimtare për t'u shpërblyer me kontratë, AK duhet ta shpërblejë me kontratë OE që dorëzon një ofertë të tillë.

Përfundimisht, bazuar në të lartcekurat, me respekt, kërkojmë nga AK që, pas shqyrtimit të kësaj Kërkesë, të marrë:

VENDIM

- I. **APROVOHET** në tërësi si e bazuar Kërkesa për Rishqyrtim e paraqitur nga OE PACS and Workflow System.
- II. **ANULOHET** vendimi i Autoritetit Kontraktues Ministria e Shëndetësisë, i datës 30.12.2024 për eliminimin e OE PACS and Workflow System nga ky aktivitet i prokurimit, dhe të shpërblehet me kontrate për këto aktivitet të prokurimit.

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Operatori Ekonomik PACS and Workflow System është i detyruar të mbrojë interesat e tij ekonomike dhe ligjore. Rrjedhimisht, në rast të vazhdimit të veprimeve kundërligjore, OE në fjalë është i detyruar të veprojë me të gjitha mjetet ligjore në dispozicion, përfshirë kërkesat për kompensim të dëmeve eventuale të cilat kanë ndodhur dhe do të shkaktohen.

Përgjigjet e Autoritetit Kontraktues ne lidhje me pretendimet ankimore:

Pretendimet e juaja ankimore janë trajtuar nga profesionistet e komisionit vlerësues ne kuadër te DSISH dhe sipas tyre ato jane te pa bazuara, ne vijim gjeni arsyetimet sipas vleresimit:

1. Lidhur me kerkesen: OE duhet të demonstrojë se produkti i ofruar është implementuar në disa arkitektura me shumë faqe. Të paktën një shembull i instalimeve në shumë vende (lokacione) duhet të dorëzohet së bashku me përshkrimin e detajuar që ilustron madhësinë e instalimit, integrimin e realizuar dhe arkitekturën e sistemit të zbatuar. Duhet të jepet informacioni i kontaktit që mund të kërkohet si provë. MSH ka të drejtë të skualifikojë OE nëse përgjigja nga referencat nuk është e kënaqshme.

Duke shqyrtuar dokumentacionin e dorëzuar nga OE, është evident se referencat e paraqitura për implementimin e projektit nuk përmbushin kërkesat e përcaktuara në tender. Së pari, është e qartë se referencat që janë ofruar për projektet e realizuara nuk i përkasin projekteve të përfunduara, por janë ende në proces të zbatimit. Ky fakt nuk i jep asnjë garanci MSH-së se produkti i ofruar është implementuar dhe funksionon në përputhje me standardet e kërkuara. Prandaj, referencat aktuale nuk mund të konsiderohen si prova të mjaftueshme për përmbushjen e kushteve të tenderit, pasi ato nuk dëshmojnë përfundimin dhe suksesin e plotë të implementimit të sistemit në një mjedis të plotë operativ.

2. OE duhet të dëshmojë se PACS është zbatuar brenda se paku një shteti të BE-së.

Përsa i përket kërkesës për të dëshmuar se PACS është realizuar brenda një shteti të Bashkimit Evropian, duhet theksuar se nuk ka asnjë dëshmi që të konfirmojë realizimin e një iniciative të natyrës së njëjtë brenda BE-së. Dëshmitë ose informacionet relevante që mund të mbështesin implementimin e këtij mekanizmi në shtetet anëtare të BE-së nuk janë të disponueshme, duke e bërë të pamundur ofrimin e një provë të tillë për realizimin e tij brenda BE-së.

Nuk ka ndonjë deklaratë bindëse ne te cilën dëshmohet qe një projekt i ngjashëm eshte implementuar ne ndonjë vend te EU, janë ofruar deklaratat te përgjithësuara qe nuk ka japin siguri.

3. Kërkesë e Tenderit: AK kërkon që sistemi të jetë i përshtatshëm për përdorim me pajisje specifike mjekësore, si skanera MRI dhe CT, dhe të jetë në gjendje të integrohet me pajisje të tilla pa ndërhyrje të mëtejshme.

Specifikimi në Propozim: Nuk ka detaje për përshtatjen e drejtpërdrejtë të sistemit me pajisje mjekësore specifike dhe aftësinë për integrim pa probleme.

Mos përputhje: Paaftësia për të siguruar integrimin e drejtpërdrejtë me pajisjet MRI dhe CT do të pengonte plotësimin e funksionaliteteve kyçe në radiologji dhe do të kërkonte zgjidhje shtesë për të mbuluar mungesat.

4. Kërkesa T: Arkitektura duhet të jetë modulare dhe fleksibël për të mundësuar zgjerime të lehta në të ardhmen pa ndryshime teknologjike të mëdha. Kjo është thelbësore për të siguruar që sistemi mund të përditësohet dhe të adaptohet me teknologjinë e re.

Mospërputhja në Propozim: Propozimi nuk përmban një përshkrim të qartë të modularitetit të sistemit dhe nuk garanton fleksibilitet për zgjerime të ardhshme pa modifikime të mëdha.

Mospërputhje: Mungesa e modularitetit e bën sistemin të ngurtë dhe të vështirë për tu përditësuar ose adaptuar. Çdo përditësim ose integrim i ri do të rrisë kostot dhe kohën, gjë që është e papranueshme për një sistem që duhet të jetë i qëndrueshëm dhe i përshtatshëm.

5. Kërkesa T: Specifikimi kërkon mekanizma të sigurtë për autentifikimin e përdoruesve dhe kontrollin e aksesit.

Kjo është një praktikë standarte për të kufizuar aksesin vetëm për personelin e autorizuar dhe për të monitoruar përdorimin e sistemit.

Mospërputhja në Propozim: Propozimi nuk përmban përshkrime për mekanizmat e MFA ose kontrollin e aksesit për të siguruar që vetëm personeli i autorizuar mund të aksesojë të dhëna të ndjeshme.

Pa autentifikim të fortë dhe kontroll të aksesit, sistemi është i ekspozuar ndaj aksesimit të paautorizuar, duke rritur rrezikun e keqpërdorimit dhe shkeljeve të të dhënave të ndjeshme.

Technical specifications

6. Must have an option for lockable front panel of the server housing, restricts access to the hard disk drives.

Mospërputhje:

Panel i kyçshem për aksesin në disqet e forta:

- Dokumenti përmend një opsion për bezel sigurie (Security bezel), por nuk ka specifikim të qartë për një panel të kyçshëm që kufizon aksesin në disqe.

7. Must have an option for a sensor to open the housing with the possibility of remote alarm settings for this event. The sensor is not part of this procurement.

Mospërputhje:

Sensor i hapjes së kasës:

- Dokumenti nuk përmend opsione për sensor që sinjalizojnë hapjen e kasës.

8. Must have an option for lockable front panel of the server housing, restricts access to the hard disk drives.

Mospërputhje:

- Panel i kyçshëm i kases: Dokumenti nuk përmend këtë specifikim direkt.

9. Must have an option for a sensor to open the housing with the possibility of remote alarm settings for this event. The sensor is not part of this procurement.

Mospërputhje:

- Sensor i hapjes së kasës: Nuk përmendet një sensor specifik për hapjen e kasës.

10. Processor: Minimum 24 cores (out of which 8 Performance-cores and 16 Efficient-cores) with total of 32 threads and 36MB intel smart cache. Frequency for the Performance-cores need to be in range of 2.0 GHz to 5.2 GHz and 1.5 GHz to 4.2 GHz on Efficient-cores.

Mospërputhje:

- Frekuenca minimale e bërthamave Performance:
- Frekuenca fillestare e Performance Cores në procesorin Intel i9-13900 është 1.5 GHz, më pak se kërkesa për 2.0 GHz minimale.

13.

Vlerësim i Produkteve të Ofruara

Kërkesa ka qenë të ketë MAF (Manufacturer's Authorization Form) për Hardware, dhe në dosjen e ofruar nga OE, MAF (Manufacturer's Authorization Form) është nga DELL dhe rrjedhimisht, si ofertë zyrtare nga OE, janë produktet e DELL.

Modeli i ofruar: 1. Dell Precision 3460 WS

Ky model nuk plotëson kërkesat minimale të kërkuara nga AK. Referuar katalogut të produktit të ofruar nga ana e OE, i cili është dokument zyrtar i publikuar nga DELL dhe të cilit i referohemi për vlerësim të produkteve, ky model nuk i plotëson specifikimet e nevojshme.

Kërkesa nga AK -ja:

Processor	Minimum 24 cores (out of which 8 Performance-cores and 16 Efficient-cores) with total of 32 threads and 36MB intel smart cache. Frequency for the Performance-cores need to be in range of 2.0 GHz to 5.2 GHz and 1.5 GHz to 4.2 GHz on Efficient-cores
-----------	---

Oferta nga OE -ja referuar Katalogut të produktit është:

PRECISION 3460 WS		DELL	
FEATURE	TECHNICAL SPECIFICATION	FEATURE	TECHNICAL SPECIFICATION
MODEL NUMBER	Precision 3460 WS		
PROCESSOR OPTIONS*	14th gen Intel® Core™ i7-14650H 13th gen Intel® Core™ i7-13620H 13th gen Intel® Core™ i5-13350H 12th gen Intel® Core™ i7-12650H 12th gen Intel® Core™ i5-12450H 11th gen Intel® Core™ i7-11650H 11th gen Intel® Core™ i5-11350H 10th gen Intel® Core™ i7-10650E 10th gen Intel® Core™ i5-10210E 9th gen Intel® Core™ i7-9750E 9th gen Intel® Core™ i5-9300E 8th gen Intel® Core™ i7-8650E 8th gen Intel® Core™ i5-8250E	ACCIDENTAL DAMAGE SERVICES	1 year Accidental Damage Service 2 year Accidental Damage Service 3 year Accidental Damage Service 4 year Accidental Damage Service 5 year Accidental Damage Service

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.


Berat Marmullaku
Zyrtari përgjegjës i Prokurimit